



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinstvo Org Unit	8.1
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No	05-211
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	- 2 -
Data: Datum: Date:	16 / 01 / 20 24
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Divizioni i Personelit / Kadrovski Odsek / Division of Personnel

Nr. 01/I/2024
Datë: 16.01.2024

Divizioni i Burimeve Njerëzore, në mbështetje të nenit 39 të Ligjit Nr. 06/L-114 Për Zyrtarët Publik, si dhe bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare, Nr. 20/21 qershor 2016), nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Anulohen konkurset:

1. Nr.ref. RN00013045, Drejtor i Departamentit të Sistemit të Informacioneve Shëndetësore;
2. Nr.ref. RN00013090, Udhëheqës i Divizionit të Mbikëqyrjes së Funkcionimit Operativ të SISH;
3. Nr.ref. RN00012975, Analist i Lartë i TI-së për Siguri;
4. Nr.ref. RN00012973, Administrator i Lartë i TI-së për Sisteme;
5. Nr.ref. RN00012976, Administrator i Lartë i TI-së për Sisteme Softuerike;
6. Nr.ref. RN00012974, Administrator i Lartë i TI-së për Rrjetin Shtetëror;
dhe
7. Nr.ref. RN00012978, Administrator i Lartë i TI-së për Baza të të Dhënave;

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Ministria e Shëndetësisë, ka publikuar konkurset si në dispozitiv të këtij vendimi, për pozitat e lira në Departamentin e Sistemit të Informacioneve Shëndetësore, duke i trajtuar si pozita të rregullta profesionale dhe janë paraparë koeficientet e pagës të barasvlefshme me pozitat udhëheqëse dhe profesionale në shërbimin civil (8.4; 7.4 dhe 5.75).

Ndërsa, bazuar në vendimin e Qeverisë Nr. 23/165 Datë: 12.10.2023, bazuar në rekomandimet e **Komisionit për vlerësimin** e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike, është aprovuar Lista e Ekspertëve e kategorizuar sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/ L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ku edhe të punësuarit në Departamentin të Sistemit të Informacioneve Shëndetësore në Ministrinë e Shëndetësisë janë kategorizuar si **“Ekspert”** dhe janë përcaktuar koeficient të veçantë për këto kategori (koeficient 12 deri 15), dhe Sistemi i Informacioneve Shëndetësore (SISH) është vlerësuar si sitem shtetëror i informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike.

Andaj, me qëllim të shmangies së kontestimit të procedurës së rekrutimit dhe me qëllim të paraqitjes së koeficienteve sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/ L-196 për Pagat në Sektorin Publik, anulohet konkursi si në dispozitiv të këtij vendimi, për tu rishpallur në përputhje me rregullat dhe procedurat.

Këshillë juridike: Palët e pakënaqura ndaj këtij vendimi mund të paraqesin ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil në afatin prej tridhjetë (30) nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Dosjeve të rekrutimit.



Z. Haki Smajli

Zv. Udhëheqës i DBNJ